



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËVE SLLAVE DHE
BALLKANIKE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Gjuhë C (2)

Ngarkesa: 4 kredite, 40 orë

Viti / Semestri : Viti I, semestri II

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Bachelor në Gjuhë angleze.

Kodi i Etikës: Kodi i etikës i UT-së (Nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore: Thellimi i njojurive gjuhësore në fushën e fjalorit dhe gramatikës së gjuhës angleze në nivel paramesatar. Zhvillimi i aftësive komunikuese në të katër aftësitë gjuhësore: të folurit, të dëgjuarit, të lexuarit dhe të shkruarit. Nxitja e ndërgjegjësimit kulturor përmes njohjes së elementeve të kulturës së vendeve anglishtfolëse dhe përdorimit të gjuhës në kontekst të përditshëm.

Objektivat specifikë lëndorë:

- 1.Zotërimi i shprehjeve frazeologjike dhe foljeve frazale, si dhe përdorimi i tyre në kontekste të përshtatshme kulturore.
- 2.Aftësimi për të komunikuar lirshëm në situata të përditshme dhe për të ndërtuar tekste të thjeshta zyrtare e jozyrtare (email, letra, histori të shkurtra).
- 3.Inkurajimi i të nxënët të pavarur, përmes përdorimit të materialeve të ndryshme gjuhësore dhe praktikave jashtë klase, me mbështetje nga pedagogu.

Rezultatet e pritshme:

- 1.Aftësia për të komunikuar në anglisht me saktësi dhe pa vështirësi të mëdha për tema të përditshme dhe tematika të librit.
- 2.Përdorimi i fjalorit të përshtatshëm për të ndërtuar tekste të thjeshta dhe për të kuptuar materiale të lexuara dhe të dëgjuara.
- 3.Kuptimi dhe analizimi i teksteve të lehta në anglisht, si dhe aftësia për t'i ripërpunuar ato në mënyrë krijuese dhe funksionale.